**SKEMA E VLERËSIMIT TË PROVIMIT TË MATURËS NGA GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA, GUSHT 2016**

**1.** Nxënësi/nxënësja* merr ***1 pikë*** nëse shkruan: të tepruarit në konsumimin e pijeve, pirja e duhanit, stresi/alkooli, pirja e duhanit, pagjumësia/niveli i ulët i vitaminës C, pirja e duhanit, pagjumësia (dhe përgjigje tjera të sakta).

**2.** Është rrethuar numri 2. *ndikimi i marrëdhënieve shoqërore në rezistencën ndaj sëmundjes nga rrufa,* ***– 1 pikë***

**3.** Nxënësi merr ***2 pikë*** nëse shkruan: me shfrytëzimin e karantinës përjashtohet mundësia që rrufën e kanë fituar diku tjetër, largësia të paktën një metër është me rëndësi sepse përjashtohet mundësia e infektimit në mes vetit dhe shenjat e rrufës i ka matur me më shumë saktësi (dhe përgjigje tjera të sakta).
Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan vetëm se shenjat e rrufës i ka matur me më shumë saktësi dhe nëse përgjigjja është e saktë, por që nuk ka stil.

**4.** Është rrethuar përgjigjja *3 – Personat që janë të vetmuara -* ***1 pikë***

**5.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: Sa më tepër që të shoqërohemi, aq më pak i nënshtrohemi sëmundjes nga rrufa./Do të duhej që të shoqërohemi sa më tepër me njerëz, jemi më të eksponuar ndaj virusit të rrufës, mirëpo hulumtimi i Kohenit tregon se shoqërimi forcon disponimin e mirë dhe përmirëson punën e funksionit imun (dhe përgjigje tjera të sakta).

**6.** Është rrethuar numri 2. *Për 30 deri në 60 ditë.* ***– 1 pikë***

**7.** Është rrethuar numri *2. Mos të pihet duhani 2 orë. -* ***1 pikë***

**8.** Është rrethuar numri *2. Sasia përkatëse e tretësirës* ***– 1 pikë***

**9.** Nxënësi merr ***2 pikë*** nëse rrethon JO dhe përshkruan ose perifrazon fjalinë: *Niveli i punës së institucioneve të transfuzionit është i tillë që përgatitja e lartë dhe profesionale e kuadrit i garanton dhuruesit të gjakut një siguri maksimale. I tërë materiali për marrjen e gjakut është steril, apirogjen dhe për përdorim të njëhershëm* ose fjalinë: *Çdo njësi e gjakut, që do të thotë gjaku i çdo dhuruesit, detyrimisht kontrollohet për: përkatësinë e grupit të gjakut, praninë e antitrupave të jashtëzakonshëm (jo të rregullt), shkaktar të sëmundjeve që mund të transmetohen përmes*

---

*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

*gjakut (sëmundjet ngjitëse) sikurse janë shkaktarët e verdhëzës, AIDS-it (SIDËS) dhe sifilizit.*

Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka rrethuar JO dhe ka shkruar saktë përgjigjen, por që ajo nuk ka stil.
***Vërejtje:*** Pranohen edhe nëse nxënësi rrethon JO, por që është përgjigjur saktë sepse konsiderohet se i ka shpëtuar gabimi. Nëse ka rrethuar PO, nuk pranohet përgjigjja.

**10.** ***Gjithsej 3 pikë.***

**A)** Është rrethuar numri 3- *Indriti* – ***1 pikë***

**B)** Nxënësi merr ***2 pikë*** përse Marku, Joni dhe Sonila nuk mund të japin gjak, kurse Indriti mundet (p.sh. Marku nuk mundet sepse atë ditë duhet të drejtojë aeroplanin dhe personave që punojnë në lartësi u rekomandohet që atëherë mos të punojnë; Joni ka dhënë gjak para dy muaj e gjysmë, kurse distanca në mes të dy dhënieve të gjakut është nga 3 deri në 4 muaj; Sonila nuk mund të jap gjak sepse para gjashtë viteve ka qenë e sëmurë nga verdhëza, dhe ajo sëmundje e përjashton përherë dhuruesin nga dhënia e gjakut; Indriti mundet të jap gjak sepse e ka marrë një ditë të lirë sepse punon saldues në një firmë (dhe përgjigje tjera të sakta).
Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shpjegohet vetëm përse Indriti mund të jap gjak ose nëse shpjegon përse Indriti mund të jap gjak, kurse emrat e tjerëve vetëm i numëron.

**11.** Është rrethuar numri *2 - Gjithë pyetjeve për topografinë ata i përgjigjen me përpikëri dhe me zgjuarsi të madhe, ndërsa shpërblimi më i mirë për ta është leja për të parë goniometrin tim*.– ***1 pikë***

**12.** **A)** kallëzore – ***1 pikë***

**B)** e pashquar – ***1 pikë***

***13.*** **A)** Nxënësi merr – ***1 pikë*** për përgjigjen e plotë të saktë: lidh.- *lidhëz;* euf. - *eufemizëm;* pj. - *pjesëz*
**B)** Nxënësi merr – ***1 pikë*** për përgjigjen e plotë të saktë: Bashkimi Evropian- *BE;* e të tjera - *etj.;* domethënë – *d.m.th.*

**14.** Nxënësi merr ***– 1 pikë*** për 4 ose 5 përgjigje të sakta: *katërshe, strofa, subjektiviteti, objektiviteti, këmba*

**15.** *Ndjenjat e shpresës, guxim e shpresë* ***– 1 pikë***

**16.** *Tercina ose strofa treshe* ***– 1 pikë***

**17.** *Rima e veçantë me skemë: aba/bcb* ***– 1 pikë***

**18.** Është rrethuar numri 3. *tre dhe nëntë – **1 pikë***

**19.** Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigjen e saktë: *përcaktorit* ***– 1 pikë***

**20.** Nxënësi merr ***– 1 pikë*** për përshkrimin e 4 ose 5 formave të sakta të foljeve të kohës së tashme nga fjalia e dytë: *nderon, ardhka, të lahen, të ta thoja, vafsh e ardhsh.*
*(**Vërejtje:** Nëse nxënësi me përgjigjet e sakta shkruan edhe përgjigjet e pasakta merr **o pikë**)*

**21.** Nxënësi merr ***– 1 pikë*** nëse ka përshkruar saktë pjesën e nënrenditur të fjalisë shkakore nga fjalia numër 3. *ngaqë përjashta ishte mjegull*

**22.** Është rrethuar numri 2. *Trajtë e bashkuar – **1 pikë***

**23. A)** *mburon – **1 pikë***

**B)** *fjala i përrallshëm i përket mbiemrit dhe është formuar me parashtesë dhe paranyjëzim njëkohësisht – **2 pikë***
Nxënësi merr ***1 pikë*** për caktimin e vetëm pjesës së ligjëratës të fjalës së dhënë ose vetëm tregon mënyrën e formimit të saj

**24. A)** *Faik Konica, Doktor Gjilpëra – **1 pikë***

**B)** *rrëfimi, proze – **1 pikë***

**25. A)** *Doktor Gjilpëra – **1 pikë***

**B)** *Lufta e brendshme e intelektualit shqiptar për atdheun e vet – **1 pikë***

**26.** *Ëndrra e madhe për një Shqipëri të përparuar* ***– 1 pikë***

**27.** Nxënësi merr ***2 pikë*** jep përgjigjen e saktë: *Personazhi kryesor dëshiron t'u ngjaj Sokratit dhe Gëtes sepse ata jetuan dhe vepruan në vendin e vet.* Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse tregon vetëm kujt dëshiron t'u ngjaj por nuk jep arsyen që i çmon lartë këta njerëz.

**28.** Është rrethuar numri *2. Melankolia dhe dhimbja botërore për pavetëdijen e botës dhe njeriut, kultivimi i ndjenjave të përkatësisë kombëtare.* *– **1 pikë***

**29.** Është rrethuar numri *3. Malarme, Rembou, Verleni – **1 pikë***

**30. Skema për vlerësimin e esesë: Takimi i botës së gjallë dhe të vdekur në veprën "Gjenerali i ushtrisë së vdekur"**

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 1.** | Nxënësi tregon:<br><br>- se misioni i tyre është të zhvarrosin trupat e ushtarëve të vendit të tyre ***– 1 pikë***<br>*Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë të tipit: ajo çka ata zbulojnë janë kujtimet, gjysmë të ndrydhura, të tmerreve të veçanta shqiptare të asaj lufte **– 1 pikë***<br><br>- se figurat e priftit dhe gjeneralit bashkë janë dy figura kundërshtuese, njëri paraqet luftën të egrën (gjenerali), kurse tjetri paraqet shenjtërinë (prifti) ***– 1 pikë***<br>*Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë të tipit: kemi një prift i cili nuk është aq shpirtëror, sepse urren shqiptarët, sepse është pjesë e luftës edhe në kohë paqeje bashkë me gjeneralin i cili paraqet stoikun, misionarin që duhet të mbaj mbi vete disfatën e luftës dhe ta takojë vdekjen në kohë paqeje **– 1 pikë***<br>**Gjithsej 4 pikë** |
| **Kërkesa 2.** | Nxënësi shkruan:<br>- se gjenerali paraqet çmitizimin e një kombi (atij italian), luftën e gjeneralit në kohë paqeje ***– 1 pikë***<br><br>*Nëse përmend luftën me të vdekurit dhe botën e saj të errët **– 1 pikë***<br><br>- se shqiptarët jepen si një popull që e duan luftën, që kanë lindur me armë në duar ***– 1 pikë***<br>- se takimi ndodh që me fillimin e vizitave familjare të të vrarëve në shtëpinë e gjeneralit, aty ai fillon ta prekë vdekjen dhe ushtrinë e tij që po e priste maleve, pastaj me fillimin e gërmimeve ***– 1 pikë***<br>**Gjithsej 4 pikë** |
| | |

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 3.** | Nxënësi shkruan:<br>- se plaka Nicë paraqet gruan dhe nënën shqiptare, ajo simbolizon forcën e dashurisë dhe dhimbjen e të gjitha nënave që humbin fëmijët e tyre gjatë luftës. Pranohen edhe interpretime tjera, të cilat i vlerëson si të pranueshme vlerësuesi/ja ***– 1 pikë***<br>- se varrosja te pragu i derës tregon që ajo donte që çdo ditë ta shkelte me këmbë ***– 1 pikë***<br>*Nëse përmend forcën e Nicës për të jetuar çdo ditë me armikun tek dera, si formë hakmarrjeje edhe kur është i vdekur* ***– 1 pikë***<br>**Gjithsej 3 pikë** |
| **Kërkesa 4.** | Nxënësi shkruan:<br>- se përballja e gjeneralit dhe kolonelit Z. fillon në dasmë në momentin që plaka Nicë i hedh thesin para, ai ndjen urrejtje dhe turp për atë thes ***– 1 pikë***<br>*Nëse shkruan se ai mohon kolonelin Z., sepse ai simbolizon të gjithë ushtrinë e vdekur, disfatën dhe tmerret që kanë shkaktuar* ***– 1 pikë***<br>- se hedhja e thesit nga gjenerali nën urë është fundi i luftës mes botës së gjallë dhe të vdekur, lufta mes kolonelit Z. të vdekur me gjeneralin e gjallë i cili nuk doli aq kryelartë ndaj shqiptarëve është tregues se të dy këto botë i humbasin bashkë me ushtritë e tyre<br>***– 1 pikë***<br>*Nëse e përmbyll me stil se ky roman na paraqet ndryshime të thella psikologjike të personazheve dhe të dy popujve* ***– 1 pikë***<br>**Gjithsej 4 pikë** |

**Gjuha dhe forma e tekstit**

| **Leksiku** | **Saktësia gjuhësore** | **Lidhshmëria** | **Struktura ndërtimore e tekstit** |
|---|---|---|---|
| origjinaliteti (interpreton me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, | respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve **për** dhe **mbi**, përemrit **i vet/ i tij**, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: **lidhur me këtë,** | lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve<br><br>**1 pikë** | përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellimit |

| | | | |
|---|---|---|---|
| fjalitë me stil<br><br>**3 pikë**<br><br>origjinaliteti (interpreton me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë me gabime minimale<br><br>**2 pikë** | **duke marrë parasysh** dhe i përemrave: **që, i cili, e cila, të cilët** etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali, renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale<br><br>**2 pikë**<br><br>respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave **r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë**, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores **ë**, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja **j**)<br><br>**2 pikë**<br><br>**Gjithsej 4 pikë** | | ndan paragrafët)<br><br>**2 pikë** |
| përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, | respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me | | ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, |

| | | | |
|---|---|---|---|
| përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta, fjalitë pa stil<br><br>**1 pikë** | përdorimin semantik të parafjalëve **për** dhe **mbi**, përemrit **i vet/ i tij,** përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit **lidhur me këtë, duke marrë parasysh** dhe i përemrave: **që, i cili, e cila, të cilët** etj.)<br><br>**1 pikë**<br><br>respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta ( p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores **ë**, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja **j**)<br>**1 pikë**<br><br>**Gjithsej 2 pikë** | | por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit<br><br>**1 pikë** |

**Skema për vlerësimin e esesë: Si të fitosh gjatë sezonit?**

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 1.** | - Nxënësi kumton mendimin e vet për punësimin sezonal/ afatshkurtër të të rinjve në Mal të Zi ***– 1 pikë***<br>- Jep argumente për qëndrimin e vet ***– 1 pikë***<br>**Gjithsej 2 pikë** |
| **Kërkesa 2.** | - Nxënësi përmend punët sezonale të cilat janë më të kërkuarat: punën e kamarierit, gjellëbërësit, punën e punëtorit të picave, vjelësit të pemëve në plantacionet e pjeshkave, rrushit, punët e shitësit të akulloreve... ***– 1 pikë***<br>*Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë* ***– 1 pikë***<br>**Gjithsej 2 pikë** |
| **Kërkesa** | - Nxënësi tregon për disa punë më të vështira apo më të lehta |

| | |
|---|---|
| **3.** | fizike (ngarkimi, shkarkimi i mallit, materialit ndërtimor ose ujit, paketimi dhe radhitja, vendosja e mallit, ngjitja e deklaratave...<br>***– 1 pikë***<br>- Nxënësi sqaron dallimin në mes të punëve më të vështira dhe atyre më të lehta ***– 1 pikë***<br>*Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë* ***– 1 pikë***<br>**Gjithsej 3 pikë** |
| **Kërkesa 4.** | - Nxënësi thekson dhe përshkruan punën sezonale të cilën do të dëshironte ta bënte ***– 1 pikë***<br>- Jep argumente me të cilat e arsyeton zgjedhjen e vet ***– 1 pikë***<br>*Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë* ***– 1 pikë***<br>**Gjithsej 3 pikë** |
| **Kërkesa 5.** | Nxënësi:<br>- thekson mangësitë e punës sezonale: punë momentale, afatshkurtër, pamundësia e realizimit të stazhit të punës, orari jo i përshtatshëm i punës, vendosja ose ushqimi, puna e mundimshme në temperatura të larta ose të ulëta...***– 1 pikë***<br>- thekson të mirat e punës sezonale; realizimin e të ardhurave shtesë, aftësimin profesional për personat që punojnë në profesion, realizimin e të ardhurave dhe mundësia për të pushuar në verë në të njëjtën kohë ose përfitimi dhe prania në një festival të muzikës, njohje të reja...***– 1 pikë***<br>- thekson dhe sqaron qëndrimin e bashkëmoshatarëve të vet për punën sezonale, se (nuk) është i dobishëm për ta.***– 1 pikë***<br>**Gjithsej 3 pikë** |
| **Kërkesa 6.** | - Nxënësi përcaktohet për një pohim dhe jep argumentet me të cilat e sqaron qëndrimin e vet ***– 1 pikë***<br>*Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë* ***– 1 pikë***<br>**Gjithsej 2 pikë** |

**Gjuha dhe forma e tekstit**

| **Leksiku** | **Saktësia gjuhësore** | **Lidhshmëria** | **Struktura ndërtimore e tekstit** |
|---|---|---|---|
| origjinaliteti (interpreton me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të | respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), kongruencës, dallimi | lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve<br><br>**1 pikë** | përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan |

| | | | |
|---|---|---|---|
| dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, fjalitë me stil<br><br>**3 pikë**<br><br>origjinaliteti (interpreton me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë me gabime minimale<br><br>**2 pikë** | semantik i parafjalëve **për** dhe **mbi**, përemrit **i vet/ i tij**, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: **lidhur me këtë, duke marrë parasysh** dhe i përemrave: **që, i cili, e cila, të cilët** etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali, renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale<br><br>**2 pikë**<br><br>respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave **r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë**, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores **ë**, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja **j**)<br><br>**2 pikë** | | qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellimit ndan paragrafët)<br><br>**2 pikë** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | **Gjithsej 4 pikë** | | |
| përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta, fjalitë pa stil<br><br>**1 pikë** | respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve **për** dhe **mbi**, përemrit **i vet/ i tij,** përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit **lidhur me këtë, duke marrë parasysh** dhe i përemrave: **që, i cili, e cila, të cilët** etj.)<br><br>**1 pikë**<br><br>respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta ( p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores **ë**, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja **j**)<br>**1 pikë**<br><br>**Gjithsej 2 pikë** | | ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit<br><br>**1 pikë** |